ALBANIAN UNIVERSITY

RREGULLORE
"PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË REGJISTRIMEVE DHE TRANSFERIMEVE "

Miratuar
Me VS Nr. 24, date 03.07.2018
Ndryshuar me VS Nr. 25, date 25.06.2020
Ndryshuar me VS Nr. 7, datë 12.03.2025
Ndryshuar me VS Nr. 12, datë 08.04.2026

Kryetari i Senatit
Prof. Dr. Julian Fink

Tiranë, më 08.04.2026

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

1. Rregullorja e Regjistrimeve dhe Transferimeve të Albanian University (AU) bazohet në Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe në Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të AU.
2. AU ofron mundësi për regjistrimin për herë të parë në vitin e parë si dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, si dhe në programe të dyta studimi.
3. Rregullorja e regjistrimeve dhe transferimeve është objekt i ndryshimeve në të ardhmen nga ana e Senatit Akademik të AU, konform çdo amendimi të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe respekton çdo akt tjetër ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për sa i përket sistemit të krediteve të transferueshme dhe fushën e zbatimit të tyre në institucionet e arsimit të lartë.

Neni 2
Qëllimi

1. Rregullorja e Regjistrimeve dhe Transferimeve ka për qëllim të përcaktojë rregullat kryesore lidhur me procedurat konkrete për regjistrimin, si dhe vlerësimin e transferimit të krediteve të përfituara nga studenti dhe njohjen e tyre.
2. Rregullorja e Regjistrimeve dhe Transferimeve përcakton gjithashtu, rregullat e përgjithshme të organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë vendimmarrëse të procesit të vlerësimit dhe transferimit të krediteve, si dhe çdo aspekt tjetër administrativ në ndihmë të realizimit të procesit të transferimeve të krediteve të përfituara nga studenti.

Neni 3
Zyra e Regjistrimeve dhe Transferimeve

1. Për realizimin e regjistrimeve dhe transferimeve të studimeve në AU është ngritur dhe funksionon Zyra e Regjistrimeve dhe Transferimeve.
2. Zyra e Regjistrimeve dhe Transferimeve në zbatim të nenit 89 të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të udhëzimeve të nxjerra nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, si dhe të akteve normative të Institucionit, ka një rol pritës dhe administrues të dokumentacionit.
3. Kompetencat e kësaj zyre parashikohen në këtë rregullore.

Neni 4
Komisioni i Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve

1. Njohja e krediteve dhe vendimi për transferim të studimeve në AU, bëhet nga Komisioni i Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve (Komisioni), mbështetur në rregullat dhe udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, duke respektuar parimet e Kartës së Bolonjës që disiplinojnë procedurat e mobilitetit të studentëve.
2. Komisioni përbëhet nga 3 ose 5 pedagogë të brendshëm të cilët emërohen me vendim nga njësia bazë, jo më vonë se muaji shtator i çdo viti.
3. Vendimi i Komisionit të Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve bazohet në vlerësimin e bërë paraprakisht nga titullarët e lëndëve përkatëse.

KREU II

PROCESI I REGJISTRIMIT

Neni 5
Kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e ciklit të parë

1. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. AU vendos kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve të cilat shpallen dhe vihen në dispozicion të QSHA-së dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Neni 6
Kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e ciklit të dytë

1. Pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të AU.
2. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit. Bëjnë përjashtim nga ky rregull programet e integruara të studimit. Kriteret miratohen sipas përcaktimeve në statutin e AU dhe bëhen publike nga njësia kryesore dhe QSHA-ja.
3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i Shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

4. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Neni 7
Kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e ciklit të tretë

1. Kriteret që duhet të përmbushë kandidati për aplikim në programet e ciklit të tretë janë kritere që miratohen nga Këshilli i Ministrave, si dhe kritere specifike akademike të cilat përcaktohen nga njësitë kryesore të AU në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

Neni 8
Aplikimi për programet e ciklit të parë dhe për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë

1. Të gjithë kandidatët, për ndjekjen e studimeve në AU, në programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit on-line në portalin e Maturës Shtetërore.
2. Aplikimi kryhet nga kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, dhe janë të pajisur me:
   a) dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor;
   b) nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, në IAL-të publike ose jopublike;
   c) plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave; dhe
   d) plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AU për programet e studimit për të cilat aplikojnë.

Neni 9
Aplikimi për programet e ciklit të dytë

1. Të gjithë kandidatët, të cilët kërkojnë të ndjekin ciklin e dytë të studimeve në AU, duhet të kryejnë procesin e aplikimit nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit pranë Zyrës përkatëse në AU.
2. Aplikimi kryhet nga kandidatët të cilët:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomë për ciklin e parë të studimeve;
b) zotërojnë dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor;
c) nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, në IAL-të publike ose jopublike ;
d) plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AU për programet e studimit për të cilat aplikojnë.

3. Në fazën e shqyrtimit të kërkesave për të ndjekur një program të ciklit të dytë "Master i Shkencave", i ndryshëm nga cikli i parë, në çdo rast, vlerësohen pozitivisht rrethanat si më poshtë vijon:

a) programi i studimit të ciklit të parë që ka ndjekur studenti çon drejtpërsëdrejti në programin e studimit të ciklit të dytë ku studenti kërkon të regjistrohet. Në këto raste studentit i njihet e drejta për t'u regjistruar në programin e zgjedhur;
b) programi i studimit të ciklit të parë që ka ndjekur studenti ka ngjashmëri jo më pak se 60% me programin bazë që çon drejtpërdrejti në ciklin e dytë. Në këto raste, për programe studimi të afërta të të njëjtit institucion apo programe të njëjta e të afërta të institucioneve të tjera të arsimit të lartë, të cilat konsiderohen të përputhshme e të pranueshme, studentit i njihet e drejta për t'u regjistruar në programin e zgjedhur;

Neni 10
Aplikimi për programet e ciklit të tretë

1. Kandidati aplikon individualisht në programin e studimit të miratuar në fushat e kërkimit shkencor, të ofruara nga njësia bazë ose njësia kryesore.
2. Njësia bazë e Fakultetit miraton programet individuale të kërkimit të kandidatëve vetëm për ato fusha të cilat u përkasin programeve të miratuara që ajo ofron.
3.Njësitë bazë të Fakultetit janë përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoraturës.Kriteret e pranimit të studentëve për në programin e studimit të doktoraturës të përcaktuara nga njësitë bazë i përcillen Dekanatit.
3. Për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoraturës aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

a. të ketë angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo të jetë personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
b. të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë një dipomë të ciklit të dytë "Master i Shkencave"/ "Master i Arteve"; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barazvlefshëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
c. të ketë rezultate të larta në studimet e ciklit të parë dhe të dytë sipas përcaktimeve të njësive bazë;

d. të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht ose spanjisht në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr.52,datë 3.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e Arsimit të Lartë"(e ndryshuar);
e. të ketë dy rekomandime nga personel akademik që kanë titullin akademik "Profesor i Asocuar" ose "Profesor" të cilët njohin aftësitë akademike të kandidatëve;
f. të mos jetë marrë masë disiplinore ndaj tij apo të mos jetë gjetur shkelje e rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standartet shkencore dhe etike;
g. të plotësojë të gjitha kërkesat e parashikuara në bazën ligjore në fuqi për programet e ciklit të tretë të studimit;
h. plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AU për programet e studimit për të cilat aplikojnë.

Neni 11
Përzgjedhja dhe shpallja e fituesve për programet e ciklit të parë

1. AU pas kryerjes së përllogaritjeve të pikëve për çdo konkurrent, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara, si dhe pas renditjes së studentëve në varësi të pikëve të grumbulluara, afishon në mjedise publike si dhe në faqen e saj zyrtare listat e renditjes së aplikuesve, ku fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.
2. Sekretaria mësimore e AU pranon dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues.

Neni 12
Përzgjedhja dhe shpallja e fituesve për programet e ciklit të dytë

1. Njësitë bazë të AU, pas kryerjes së aplikimit nga kandidatët për ciklin e dytë të studimeve, në bazë të kritereve ligjore dhe kuotave të përcaktuara rendisin kandidatët fitues.
2. Listat e fituesve shpallen dhe afishohen, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë, në mjedise publike si dhe në faqen zyrtare të universitetit. Fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.
3. Sekretaria mësimore e AU pranon dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues.

Neni 13
Dokumentacioni i nevojshëm për programet e ciklit të parë

1. Kandidatët dorëzojnë personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) fotokopje e një dokumenti identifikimi;
b) fotokopje e njehsuar me origjinalin e diplomës së Maturës Shtetërore ose dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese apo diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në ministrinë përgjegjëse të arsimit.

Neni 14
Dokumentacioni i nevojshëm për programet e ciklit të dytë

1. Kandidatët e programeve të ciklit të dytë dorëzojnë dokumentet e përcaktuara në nenin 14 dhe:

a) diplomën e ciklit të parë të studimeve (fotokopje të njehsuar me origjinalin) ose në rastet e diplomimit jashtë Republikës së Shqipërisë, njehsimin e diplomës së fituar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë;
b) dëshmi të gjuhës së huaj në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi;
c) CV të detajuar;
d) çdo dëshmi tjetër kualifikimi.

Neni 15
Dokumentacioni i nevojshëm për programet e ciklit të tretë

1. Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoraturës bën një kërkesë, e cila përfshihet në dosjen personale, që dorëzohet në njesinë bazë dhe përmban dokumentat e mëposhtëm:

a. Curriculum Vitae;
b. Kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplemente të diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse;
c. Çertifikatë lindjeje, si dhe fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
d. Dy rekomandime nga personel akademik me titull "Profesor i Asocuar" ose "Profesor";
e. Dëshmi të gjuhës së huaj sipas kritereve të udhëzimt përkatës.
f. Dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të kenë kryer apo pjesëmarrje në konferenca;
g. Deklaratë e gadishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin;
h. Vërtetim nga qendra e punës, që vërteon se kandidati ka angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo është personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
i. Mandat pagesë për tarifën e aplikimit;
j. Vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standartet etike dhe shkencore;
k. Deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoraturës nëse do të vetfinancohet;

l. Për Specializimet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore: të ketë kryer me sukses provimin e shtetit përkatës konform ligjit 1017, dt. 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), dhe të ketë përftuar të drejtën e ushtrimit të profesionit përkatës në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj (e njohur në Republikën e Shqipërisë).

Neni 16
Procedura e regjistrimit

1. Pranimet e studentëve në të gjitha programet e studimit bëhen në përputhje me standardet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore dhe kriteret e pranimit të vendosura nga njësitë bazë dhe njësitë kryesore.
2. Zyra e Regjistrimit dhe Transferimeve mban regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati ka të drejtë të kryejë çregjistrim nga programi i studimit, vetëm në datat e përcaktuara sipas akteve ligjore, ku më pas i krijohet mundësia për të riaplikuar përsëri për Raundin e radhës.
Pas përfundimit të afatit të regjistrimeve studenti nuk ka më të drejtë të ndryshojë programin e studimit për atë vit akademik.
3. Pas regjistrimit të studentit dosja e tij i kalon sekretarisë përkatëse mësimore, e cila është përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e saj.
4. Të gjithë studentët e regjistruar në AU sipas afateve dhe udhëzimeve të ministrisë përkatëse të arsimit, i përcillen QSHA-së për të vijuar më tej me procedurën e matrikullimit.

Neni 17
Çregjistrimi

1. Procesi i çregjistrimit gjendet në dy forma:
   a) *Çregjistrimi ndërmjet raundeve*, parashikohet në data të përcaktuara nga ministria përkatëse e arsimit për aplikantët e regjistruar në fillim të vitit akademik gjatë raundit të parë ose të dytë, të cilët nuk janë të kënaqur me programin e studimit të përzgjedhur dhe duan të riprovojnë aplikimin në raundin pasardhës. Ky çregjistrim është i parashikuar vetëm për programet e studimit të ciklit të parë.
   b) *Çregjistrimi gjatë viteve akademike*, studentët të cilët dëshirojnë të largohen nga Albanian University (*studentë në dalje*) duhet të plotësojnë "Kërkesën për çregjistrim" pranë sekretarisë mësimore përkatëse. Kryesekretarja e Fakultetit pas protokollimit të kërkesës, përcjell praktikën përkatëse tek Dekani për miratim.

2. Pas miratimit nga Dekani, Sekretaria mësimore harton praktikën e çregjistrimit duke bashkëlidhur dokumentacionin e plotë me të dhënat si vijon:

a) detyrimet e shlyera me notat përkatëse;
b) dëftesën e shkollës së mesme ose të ciklit të parë apo të dytë (në rastet kur janë mbajtur nga Institucioni);
c) vërtetim çregjistrimi;
d) një kopje e programeve të lëndëve përkatëse të shlyera nga studenti me vulë të institucionit dhe firmë të Rektorit të Universitetit, me kërkesë të studentit.

3. Pas tërheqjes së dokumentacionit të mësipërm, sekretaria mësimore detyrohet të kryejë çregjistrimin e studentit nga Regjistri themeltar.

KREU III

PROCESI I TRANSFERIMIT TË STUDIMEVE

Neni 18
Transferimi i studimeve

AU ofron mundësi për transferimin e studimeve në të njëjtin cikël studimi, brenda të njëjtit institucion, degë apo institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose private, vendase ose të huaja, sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 19
Procedura e transferimit të studimeve

1. Studentët që duan të transferohen në AU duhet të plotësojnë formularin e aplikimit për transferim pranë Zyrës së Regjistrimeve dhe Transferimeve.
2. Zyra e Regjistrimeve dhe Transferimeve, pas pranimit të Formularit të Aplikimit, protokollimit të kërkesës (formular aplikimi), plotëson dosjen e kandidatit duke bashkëlidhur dokumentacionin e plotë me të dhënat si vijon:

a) kërkesë me shkrim e studentit që kërkon transferimin e krediteve;
b) listë notash të lëndëve të shlyera për të cilat kërkon transferimin;
c) syllabus-et e të gjitha lëndëve, për të cilat ka shlyer kreditet që kërkon të transferojë;
d) diplomë të ciklit të parë, kur kërkohet njohja e këtyre krediteve për transferimin në një program tjetër studimi të ciklit të parë; ose
e) diplomë të ciklit të dytë, kur kërkohet njohja e këtyre krediteve për transferimin në një program tjetër studimi të ciklit të dytë; ose

f) diplomë e programeve të studimit postmaster, kur kërkohet njohja e këtyre krediteve për qëllimin e njohjes së krediteve teorike në programet e ciklit të dytë dhe ciklit të tretë;
g) vërtetim çregjistrimi (me elementët e përcaktuar me udhëzim nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë);
h) dokument identifikimi;
i) 2 fotografi personale.

I gjithë dokumentacioni duhet të përmbajë firmën dhe vulën e institucionit që e formulon.

3. Dosja e plotë i dërgohet për shqyrtim dhe vlerësim njësisë bazë. Zyra e Regjistrimeve dhe Transferimeve gjatë procedurës së vlerësimit të dosjes së kandidatit ka të drejtë të kryejë veprime mbi verifikimin e diplomës apo dëshmive të tjera të lëshuara nga institucione të tjera arsimore, nga ku kërkohen të transferohen kreditet, me qëllim vazhdimin e studimeve.

4. Me marrjen në dorëzim të dosjes nga njësia bazë, titullarët e lëndëve bëjnë vlerësimin për të gjitha lëndët me notë kaluese të sjella nga kandidati, në përputhje me planin mësimor të programit të studimit ku ai kërkon të transferohet. Titullarët e lëndëve përkatëse vlerësojnë nëpërmjet nënshkrimit të tyre njohjen ose mosnjohjen e lëndëve, temave, moduleve, të shprehura në kredite.

5. E gjithë praktika e vlerësimit të njohjes apo mosnjohjes së krediteve, përmblidhet në një shkresë nga ana e drejtuesit të njësisë bazë dhe i përcillet Komisionit të Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve.

6. Komisioni i Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve, brenda afateve të përcaktuara me udhëzim nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, vendos për:
a) njohje të diplomave me qëllim vazhdimin e studimeve në një nivel tjetër si dhe regjistrimin e studentëve në të tre ciklet e studimit;
b) njohje dhe njehsim të periudhave të studimit të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja për vazhdimin e studimeve të njëjta ose të ngjashme pranë AU;
c) njohje të krediteve (lëndë, module ose tema) të fituara në një program studimi, ose formime të tjera pas shkollës së mesme, që përkojnë me formimin e programit të studimit;
d) vlerësimin e programit, pjesëve të tij, lëndëve/moduleve/tema, dhe verifikon diplomën e lëshuar me qëllim regjistrimin në programin e kërkuar nga studenti;
e) vitin e studimeve në të cilin studenti kalon;
f) lëndët, modulet, temat me kreditet që i njihen; dhe
g) detyrimet që studenti ka për të shlyer, që sipas planit mësimor përkatës, do t'i njihen si lëndë/modul/kredite të mbartura.

7. Ky vendim bashkë me shkresën me vlerësimet e titullarëve të lëndëve i përcillet Zyrës së Regjistrimeve dhe Transferimeve dhe Dekanit të njësisë kryesore.

8. Zyra e Regjistrimeve dhe Transferimeve informon kandidatin dhe nëse ai bie dakord me vendimin e njohjes së krediteve dhe transferimit të studimeve, i nënshtrohet procedurës së regjistrimit sipas Nenit 16 të kësaj Rregulloreje.

9. Me përfundimin e afateve të përcaktuara me udhëzim nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, Dekani përmbledh praktikën e transferimeve, me anë të një vendimi, për të gjithë studentët e regjistruar me transferim.

Neni 20
Njohja e krediteve

1. Procedura e njohjes së krediteve dhe e transferimit të studimeve në AU bëhet nëpërmjet vlerësimit të sistemit të studimit, formës së studimit, elementeve të programit të studimit dhe të gjithë elementëve të parashikuara në këtë rregullore.
2. Komisioni i Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve, për çdo kërkesë të paraqitur bën:
   a) njohje të plotë ose të pjesshme të krediteve të përfituara në një program studimi brenda apo jashtë institucionit me qëllimin e transferimit të tyre në një program studimi të të njëjtit cikël në AU;
   b) njohje të krediteve të fituara, pas arsimit të mesëm, në një program studimi jo universitar, profesional, me një kohëzgjatje dy-vjeçare dhe me jo më pak se 120 kredite, me qëllimin e njohjes së tyre në një program studimi të ciklit të parë. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite. Për programet e studimeve të ciklit të dytë numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 40 (dyzet) kredite.

3. Kur dokumentacioni përcjellës i studentit nuk përmban vlerësimin në kredite ECTS, njësia bazë bën vlerësimin e tyre edhe në kredite mbështetur në raportin e orëve (veprimtari në auditor + studim individual) sipas rregullave që përdoren në këtë institucion dhe ia përcjell Komisionit.
4. Për lëndë me zgjedhje të shlyera në programin nga vjen studenti, të cilat nuk janë në kurrikulën e programit të studimit ku kërkon të transferohet studenti, Komisioni vendos rast pas rasti nëse këto lëndë mund të njihen si lëndë me zgjedhje në programin përkatës të AU, pavarësisht nëse ofrohen nga programi ku studenti kërkon të transferohet, deri në numrin e caktuar të grupeve të lëndëve me zgjedhje që ofron programi i studimit.

Neni 21
Transferimet në ciklin e parë të studimeve

1. Për transferimin në ciklin e parë të studimeve vlerësohen elementet si më poshtë vijon:
a) nivelin e ciklit të studimit në të cilin janë përfituar kreditet nga studenti, nëse ai përputhet me atë pritës;
b) syllabus-et; Nëse syllabus-et nuk përputhen së paku 65% me ato të lëndës analoge të ofruar nga Institucioni ynë, atëherë bëhet njohje e pjesshme,

c) sistemin e vlerësimit dhe njohjen e rezultateve të arritura: në rast se sistemi i vlerësimit të AU është i ndryshëm nga ai i institucionit ku janë shlyer kreditet që kërkojnë të transferohen, komisioni rast pas rasti mundohet të përshtatë sistemin e vlerësimit të huaj me atë të AU;
d) vitet e studimit dhe kohëzgjatjen e tyre.
2. Në çdo rast Komisioni merr vendim lidhur me aplikimin e bërë nga studenti. Komisioni përcakton rast pas rasti njohjen e plotë, të pjesshme (me debi formimi), si dhe vitin akademik, në të cilin mund të regjistrohet studenti.
3. Me njohjen e pjesshme me debi formimi dhe provimi do të kuptojmë ato raste, në të cilat mosplotësimi i detyrimeve të studentëve, për shkak të diferencave në programet mësimore të lëndëve dhe diferenca në numër kreditesh ngarkon si rrjedhojë studentin me detyrimin për të shlyer një numër të caktuar kreditesh që i korrespondojnë një numri të caktuar temash, lëndësh apo modulesh. Studenti ka detyrimin për t'i shlyer këto kredite gjatë studimeve në vijim, me qëllim përfitimin e formimit akademik sipas programit të ri të studimit.
4. Në përcaktimin e vitit akademik ku do të regjistrohet studenti, Komisioni vendos sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) studenti mund të regjistrohet në vitin e dytë nëse atij i janë njohur minimalisht një numër prej 30 kreditesh në programin e studimit pritës;
b) studenti mund të regjistrohet ne vitin e tretë nëse atij i janë njohur minimalisht një numër prej 60 kreditesh në programin e studimit pritës, prej të cilave minimumi 25 % të vitit paraardhës.

Neni 22
Transferimet në ciklin e dytë të studimeve

1. Për transferimin në ciklin e dytë të studimeve, vlerësohen elementet si më poshtë vijon:

a) niveli i ciklit të studimit në të cilin janë përfituar kreditet nga studenti, nëse ai përputhet me atë pritës;
b) syllabus-et. Nëse syllabus-et nuk përputhen së paku 65% me ato të lëndës analoge të ofruar nga Institucioni ynë, atëherë bëhet njohje e pjesshme;
c) sistemi i vlerësimit dhe njohjen e rezultateve të arritura: në rast se sistemi i vlerësimit të AU është i ndryshëm nga ai i Institucionit ku janë shlyer kreditet që kërkojnë të transferohen, njësia bazë rast pas rasti mundohet të përshtatë sistemin e vlerësimit të huaj me atë të AU;
d) vitet e studimit dhe kohëzgjatjen e tyre.

2. Në çdo rast Komisioni merr vendim lidhur me aplikimin e bërë nga studenti. Komisioni përcakton rast pas rasti njohjen e plotë, të pjesshme (me debi formimi), si dhe vitin akademik në të cilin duhet të regjistrohet studenti.
3. Në përcaktimin e vitit akademik ku do të regjistrohet studenti Komisioni i Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve vendos sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Për programet "Master Profesional" me kohëzgjatje një vit akademik studenti mund të regjistrohet me transferim, edhe nëse atij i është njohur plotësisht ose pjesërisht qoftë edhe vetëm një lëndë, në programin e studimit të AU.
b) Për programet "Master i Shkencave" me kohëzgjatje prej 2 vitesh, studenti mund të regjistrohet në vitin e dytë nëse atij i janë njohur minimalisht një numër prej 30 kreditesh në programin e studimit pritës;
c) Për programet e integruara, studenti mund të transferohet në vitin e dytë nëse atij i janë njohur minimalisht një numër prej 30 kreditesh ne programin e studimit pritës. Studenti mund te transferohet ne vitin e trete, nëse atij i janë njohur minimalisht një numër prej 60 kreditesh ne programin e studimit pritës, prej te cilave minimumi 25 % te vitit paraardhës. Studenti mund të transferohet në vitin e katërt nëse atij i janë njohur minimalisht një numër prej 90 kreditesh në programin e studimit pritës, prej të cilave minimumi 25 % të vitit paraardhës. Studenti mund të transferohet në vitin e pestë nëse atij i janë njohur minimalisht një numër prej 150 kreditesh në programin e studimit pritës, prej të cilave minimumi 25 % të vitit paraardhës.

4. Institucioni pranon kandidatë që kanë fituar një diplomë "Master Profesional" në studimet e ciklit të dytë për diplomën universitare "Master i Shkencave" dhe anasjelltas.

Neni 23
Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Të drejtën për të ndjekur një program të dytë studimi të të njëjtit cikël në AU, e kanë të gjithë ata studentë të cilët kanë përfunduar një program studimi.
2. Vendimi për ndjekjen e një programi të dytë studimi, merret nga Rektori mbi bazë të propozimit të Dekanit të njësisë kryesore përkatëse, pasi të jenë përmbushur të gjitha etapat e procedurës së transferimit sipas Nenit 19 të kësaj rregulloreje, me përjashtim të pikës 2/g dhe pikës 8.

Neni 24
Transferimi i brendshëm

AU lejon edhe transferimet e brendshme. Transferime të brendshme do të konsiderohen transferimet që kërkohen nga studentët e AU të cilët dëshirojnë të ndryshojnë programin e studimit brenda të njëjtit cikël studimesh. Komisioni i Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve jep vlerësimin e tij në lidhje me këtë aplikim. Brenda institucionit njihen të gjitha lëndët dhe kreditet që janë në përputhje me programin e studimit ku studenti kërkon të transferohet.

Neni 25
Plotësimi i dosjes

1. Dosja e kandidatit për Student përpara regjistrimit në programin e përzgjedhur duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

a) Kërkesa e studentit;
b) Shkresën përmbledhëse të vlerësimit nga çdo pedagog për lëndët përkatëse;
c) Vendimin e Komisionit;
d) Vendimin e Dekanit;
e) Listën e notave te programit nga i cili transferohet;
f) Syllabus-et, kurrikulën, planin mësimor të të gjitha lëndëve për të cilat ka shlyer kreditet që kërkon të transferojë;
g) Fotokopje e dokumentit te identifikimit;
h) Vërtetim çregjistrimi;
i) Diplomën e shkollës së mesme ose dublikatën e saj të sigluar nga Drejtoria Arsimore Rajonale përkatëse, nëse programi i studimit në të cilin regjistrohet është program i ciklit të parë;
j) Diplomën e njëhsuar me origjinalin të ciklit të parë nëse programi i studimit në të cilin regjistrohet është program i ciklit të dytë;
k) Diplomën e njehsuar me origjinalin të ciklit të dytë nëse programi i studimit në të cilin regjistrohet është program i ciklit të dytë dhe të tretë;
l) 2 fotografi.

2. Për transferimin në ciklin e tretë duhet të depozitohen dhe kërkesat e veçanta të kërkuara për këto programe studimi.
3. Kandidati duhet të pranojë dhe të kryejë në kohën e caktuar pagesën e tarifës së shkollimit në AU sipas kushteve të vendosura në kontratën e tij të studimit.

Neni 26
Dispozitat e fundit

1. Ndryshimet e Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të AU.
2. Çdo ndryshim i Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve propozohet nga strukturat përgjegjëse të AU dhe miratohet nga Senati Akademik.
3. Universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e kësaj rregulloreje.
4. Senati Akademik ka të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje.
5. Pjesë integrale e kësaj rregullore, janë edhe shtojcat që i bashkëngjiten.
6. Rregullorja hyn në fuqi menjëherë.